



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 · E-mail: filologjia@uni-pr.edu · www.filologjia.uni-pr.edu

Komisioni për shqyrtimin e ankesave

Nr. Prot.:

03/B78

Datë: 17.7.2026

Mbështetur në Vendimin me nr. prot. 01/2263, datë 8/7/2026 të Këshillit të Fakultetit të Filologjisë dhe në zbatim të Konkursit me nr. 2/1, dt. 29/6/2026 të Senatit të UP-së, Komisioni për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve të pakënaqur me rezultatin preliminar të provimit pranues për pranimin e studentëve të rinj në studimet master, në vitin akademik 2026/27, mori

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t si e pabazuar ankesa me nr. prot. 04/2371, datë 17.07.2026, e parashtruar nga kandidatja me nr. të aplikimit 100145 në Programin e Integruar të Gjuhësisë, ndaj rezultatit preliminar të shpallur më 15.07.2026.
- II. **KORIGJOHE**t rezultati preliminar në Programin Master "Gjuhë dhe Letërsi Turke", në përputhje me kuotat e përcaktuara në Konkursin e miratuar me Vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës nr. 2/1, datë 29.06.2026.
- III. **VËRTETOHEN** rezultatet preliminare të provimit pranues për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2026/2027, të publikuara më 15.07.2026, me përjashtim të korrigjimit të bërë sipas pikës II të këtij vendimi.

Arsyetim

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 17.07.2026, shqyrtoi ankesat e kandidatëve të pakënaqur me rezultatin preliminar të provimit pranues për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2026/2027.

Komisioni i Ankesave, në përbërje të plotë, shqyrtoi ankesat e kandidatëve duke iu referuar dispozitat e Konkursit nr. prot. 2/1, datë 29.06.2026. Pas pranimit të ankesave të parashtruara, ai iu drejtua komisioneve vlerësuese me kërkesë për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve lidhur me vlerësimin. Pas rishqyrtimit të pretendimeve nga komisionet vlerësuese dhe konfirmimit të rezultateve të vlerësimit, Komisioni i Ankesave mori vendimin përkatës.

Lidhur me pikën II të vendimit, Komisioni i Ankesave shqyrtoi dispozitat e konkursit që rregullojnë kuotat e pranimit në Programin Master "Gjuhë dhe Letërsi Turke".

Pas pranimit të sqarimeve nga administrata e njësisë akademike dhe administrata qendrore e Universitetit të Prishtinës, u konstatua nevoja për harmonizimin e rezultatit preliminar me kuotat e përcaktuara.

Rrjedhimisht, Komisioni Vlerësues bëri korrigjimin e rezultatit preliminar, duke marrë parasysh kuotat e rezervuara për komunitetet, në përputhje me dispozitat e konkursit.

Duke marrë parasysh sa u tha më lart, si dhe raportet e komisioneve në nivel departamentesh, pas konsultimit me kandidatët, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Komisioni i Ankesave:

Prof.asst. Faton Ismajli – kryetar

Prof.asst. Ardita Berisha – anëtare

Asst. Ilir Breca – anëtar

